



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Shëndetësisë / Ministarstvo Zdravstva / Ministry of Health

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Nacionalni Institut za Javno Zdravstvo Kosova / National Institute of Public Health of Kosova

RAPORTI I GJENDJES PERINATALE NË KOSOVË PËR VITIN 2016

Observatori për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe të Rinjve - IKSHPK

**RAPORTI I GJENDJES
PERINATALE NË KOSOVË PËR
VITIN 2016**

Prishtinë, 2017

Botuesi:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Copyright:

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës

Përdorimi i të dhënave lejohet vetëm kur citohet burimi i të dhënave.

Parathënie

Publikimi “Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2016” përfshin të dhënat në dispozicion të raportuara nga institucionet shëndetësore dhe Agjensioni i Statistikave të Kosovës (ASK).

Në këtë publikim përfshihen të dhënat mbi definicionet, lindjet dhe vdekshmërinë e foshnjeve të ndarë sipas periudhave të ndryshme të jetës së foshnjeve. Të dhënat kryesore perinatale dhe lindjet janë të prezantuara sipas viteve 2000-2016. Lindjet janë të raportuara sipas niveleve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike dhe private.

Të porsalindurit janë të prezantuar sipas grup-peshës dhe mënyrës së lindjes.

Foshnjët e vdekura janë të prezantuara sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës, rradhës së lindjes, statusit martesor dhe nivelit të edukimit të nënës.

Koeficientët e vdekshmërisë perinatale dhe infantile janë të prezantuara sipas komunave.

Falenderojmë të gjitha institucionet shëndetësore të Kosovës të cilat ofruan bashkëpunim në mbledhjen e të dhënave. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si informacion shumë i dobishëm për t’u njohur më mirë me gjendjen perinatale në Kosovë.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij hulumtimi për bashkëpunim duke dhënë vërejtje, komente dhe propozime me qëllim të ngritjes së cilësiosë në këtë lëmi tejet të domodoshme për zhvillimin, planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në Kosovë në dobi të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës.

Prof. Dr. Naser Ramadani, MD., PhD., C.M.I.S., C.I.E.H.

Drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	6
PËRMBLEDHJE	7
DEFINICIONET	8
TË DHËNAT KRYESORE.....	10
LINDJET.....	11
VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVER.....	15
VDEKSHMËRIA FETALE.....	18
VDEKSHMËRIA PERINATALE.....	19
PËRFUNDIMI	22
REKOMANDIMET	23
BIBLIOGRAFIA	23

PËRMBLEDHJE

Në vitin 2016 sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës-IKSHPK nga institucionet shëndetësore janë raportuar gjithsej 24,092 lindje me 24,852 të porsalindur. Afro një e katërta e lindjeve (24.3%) janë kryer me Sectio Cesarea (SC).

Të porsalindur gjallë janë 24,697, të lindur të vdekur (vdekje fetale) 156 (6.03‰, vdekje të hershme neonatale janë raportuar 121 (4.9‰) dhe 277 vdekje perinatale (11.2‰).

DEFINICIONET

Definicionet e indikatorëve janë shfrytëzuar nga korniza e treguesve të shëndetit të fëmijës dhe nënës e cila është produkt i grupit punues në nivel nacional dhe i përkrahur nga Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit në Republikën e Kosovë, Ministria e Shëndetësisë, IKSHPK dhe UNICEF-i.

I lindur nënkupton shpëputjen e tërësishme e fetusit të vdekur që peshon më shumë se 500 g apo të fetusit të gjallë nga trupi nënës pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënisë.

I lindur të gjallë nënkupton shpëputjen e tërësishme nga trupi i nënës të produktit të konceptimit, pavarësisht nga kohëzgjatja e shtatzënisë, i cili produkt pas ndarjes, merr frymë apo tregon shenja të jetës si p.sh të rrahurat e zemrës, pulsimit të kordonit të kërthizës apo lëvizje vullnetare të muskujve, pavarësisht nëse kordoni i kërthizës është prerë apo placenta është ngjitur.

I lindur vdekur : Vdekja para daljes apo nxerrjes prej nënës së vet e produktit të konceptimit pa marrë parasysh kohëzgjatjen e shtatzënisë; vdekja është përcaktuar sipas faktit se pas ndarjes së tillë fetusit nuk merr frymë apo nuk tregon ndonjë shenjë tjetër jete, siç janë rrahjet e zemrës, pulsimet e kordonit umbilikal apo lëvizjet e përcaktuara të muskujve të vullnetshëm (ASK)

Shkalla e të lindurve të vdekur (Vdekshmëria fetale)

Numri i të lindurve të vdekur për 1,000 të lindur (të lindur gjallë dhe të lindur të vdekur). Vdekja e frytit mund të ndodhë para lindjes – gjatë shtatzënisë dhe gjatë lindjes.

Për qëllime të krahasimeve kombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale (≥ 500 g ose ≥ 22 javë).

Për qëllime të krahasimeve ndërkombëtare, lindjet e vdekura janë të definuara si tremujor i tretë i vdekjeve fetale ($\geq 1,000$ g ose ≥ 28 javë).

Shkalla e vdekshmërisë perinatale

Numri i vdekjeve perinatale (të lindur të vdekur dhe vdekje të hershme neonatale) e shprehur për 1,000 të lindur.

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (mortaliteti neonatal) definohet si numri i fëmijëve të lindur të gjallë që vdesin pa i mbushur 28 ditë të jetës (0-27 ditë), e shprehur për 1,000 të lindur gjallë brenda një viti kalendarik.

Vdekjet neonatale (vdekjet gjatë 28 ditëve të para të jetës së foshnjës) mund të ndahen në:

vdekjet e hershme neonatale, që ndodhin brenda 7 ditëve (0-6 ditë) të para të jetës dhe

vdekjet e vonshme neonatale që ndodhin pas ditës së 7, (7-27 ditë), por para se të përfundohet dita e 28-të.

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjave (Mortaliteti infantil)

Shkalla e vdekshmërisë së foshnjeve paraqet numrin e foshnjeve të vdekura para moshës 1 vjeçare (0-11 muaj) të shprehur për 1,000 të lindur të gjallë, në një periudhë të caktuar kohore. Vdekshmëria e foshnjave paraqet probabilitetin që fëmija të vdesë para se t'i mbushë 1 vjet për 1,000 të lindur të gjallë.

Shkalla e vdekshmërisë maternale paraqet numrin e grave të vdekura nga ndonjë shkak që lidhet me (ose është shkaktuar nga) shtatzëninë (duke përjashtuar shkaqe aksidentale apo të rastësishme) dhe vdekjet gjatë lindjes ose brenda 42 ditëve pas përfundimit të shtatzënisë, pavarësisht nga kohëzgjatja dhe vendi i shtatzënisë, e shprehur në 100,000 të lindur gjallë, për një periudhë të caktuar kohore.

TË DHËNAT KRYESORE

Të dhënat perinatale kryesore për vitin 2016 janë raportuar nga institucionet shëndetësore publike dhe private (duke mos përfshirë të dhënat nga maternitetet e Graçanicës dhe Mitrovicës Veriore):

- 24092 lindje
- 24852 të porsalindur
- 24697 të porsalindur gjallë
- Raporti gjinor në lindje është 1096.2 meshkuj në 1000 femra
- Shkalla e lindjeve me prerje Cezariene është 24.3 %
- Gjithsej 199 foshnje të vdekura
- 156 (6.3‰), vdekje fetale*
- 121 (4.9 ‰) vdekje të hershme neonatale (0-6 ditë)
- 277 (11.2‰) vdekje perinatale (vdekje fetale + hershme neonatale)
- 29 (1.2 ‰) vdekje të vonshme neonatale (7-27 ditë)
- 150 (6.1 ‰) vdekje neonatale (0-28 ditë)
- Shkalla e vdekshmërisë perinatale për të posalindurit me peshë $\geq 1,000$ gram që shfrytëzohet për krahasime ndërkombëtare është 11.2 ‰ (vdekshmëria fetale 6.3 ‰ dhe vdekshmëria e hershme neonatale 4.9 ‰).

Tabela 1. Të dhënat kryesore perinatale krahasuar përgjatë viteve

Modalitetet	2000	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i lindjeve	39.091	27,548	28,525	27,069	26,565	24,611	24092
Numri i të porsalindurve të lindur të gjallë	38.907	27,725	28,664	27,277	26,787	24,812	24697
Numri i vdekjeve fetale	572	252	284	278	226	177	156
Shkalla e vdekshmërisë fetale (‰)	14.5	9	9.81	10.09	8.37	7.08	6.3
Numri i foshnjeve të vdekura në javën e parë	577	248	218	170	98	126	121
Shkalla e mortalitetit të hershëm neonatal (‰)	14.8	8.9	7.61	6.23	3.66	5.08	4.9
Shkalla e vdekshmërisë perinatale (‰)	29.1	17.87	17.34	16.26	11.99	12.13	11.2
Shkalla e lindjeve me prerje cezariene (%)	7.5	21.8	20.9	25.2	26.9	27.3	24.3

Burimi: Raporti perinatal (2000-2015)

IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

LINDJET

Sipas IKSHPK-së janë 24,092 lindje, të lindur gjallë 24,697 dhe të lindur vdekur 156, ndërsa sipas ASK 23494 lindje në Kosovë, 23416 të lindur gjallë, dhe 78 të lindur vdekur (Tab.2).

Tab.2 Raportimi i te dhënave nga dy burimet e të dhënave

Institucioni	Lindje (lehona)	Të lindur gjallë	Të lindur vdekur
IKSHPK	24092	24697	156
ASK	23494	23416	78

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016
ASK-Statistikat e Lindjeve, 2016

Bazuar në raportin e IKSHPK-së: “Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016”, sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitalet e përgjithshme me 12,810 apo 53.2%, pason klinika obsterike gjinekologjike e QKUK-së me 10,139 apo 42.1%, në maternitete 654 lindje apo vetëm 2.7%, ndërsa në spitalet private, spitali Bahceci dhe spitali Amerikan 489 raste ose 2.0% (Tab.3).


Tab. 3 Lindjet sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, institucionit, Kosovë-2016

Institucioni	Lindje		Foshnje të lindura		Foshnje të lindur gjallë		Të lindur pa jetë	
	N	%	N	%	N	%	N	%
QKUK	10139	42.1	10376	41.7	10274	41.6	102	65.4
SPITALI	12810	53.2	13318	53.6	13264	53.7	51	32.7
MATERNITETE	654	2.7	656	2.6	656	2.7	0	0.0
SPITALE PRIVATE	489	2.0	503	2.0	500	2.0	3	1.9
TOTALI	24092	100.0	24853	100.0	24694	100.0	156	100.0

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

Sipas komunave, më së shumti lindje janë realizuar në Prishtinë 13.9%, në Prizren 9.6% dhe Ferizaj 6.6%. (Graf.1)

Graf.1 Struktura e lindjeve sipas komunave, 2016




Burimi: ASK-Statistikat e Lindjeve, 2016

Trendi i lindjeve


Në vitin 2016 ka vazhduar trendi i rënies së lindjeve të raportuara nga institucionet shëndetësore, si publike ashtu edhe ato private. Gjithsej 24,092 lindje janë raportuar këtë vit (duhet patur parasysh se në këtë shifër nuk janë përfshirë lindjet nga Graçanica dhe Mitrovica veriore, pasi që këto maternitete nuk kanë raportuar të dhënat për vitin 2016). Në vitin 2016 ekziston një rënie e numrit të lindjeve për 519 lindje më pak, krahasuar me vitin 2015 (Graf.2). Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore më i larti është në klinikën Gjinekologjike Obsterike të QKUK-së me 28 lindje, pason Prizreni me 10 lindje, Peja me 6 lindje dhe më së paku në Vushtrri me 1 lindje në ditë (Graf. 3).

Graf.2 Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2016



Burimi: ASK, lindjet


Graf.2a Trendi i lindjeve, Kosovë 2000-2016



Burimi: Raporti perinatal (2000-2015)

IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

Graf.3. Numri mesatar i lindjeve në ditë në institucionet shëndetësore spitalore




Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

Trendi i lindshmërisë në 1000 banorë për periudhën 2000-2016

Gjatë vitit 2000, nataliteti ishte 19.3‰, ndërsa në vitin 2016 ishte 13.1‰. Lindshmëria për periudhën 2000-2016 ka trend të rënies me lëvizje variable (Graf.4).

Graf.4 Trendi i natalitetit, Kosovë 2000-2016



Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2016

Sipas ASK-së, pjesmarrje më të madhe në lindje ka grup pesha 3000-3499 me 37.4% dhe 3500-3999 me 31.3%. (tab.4) ndërsa sipas IKSHPK-së, nga të dhënat e raportuara 21,486 apo 87.0% i takojnë grup peshës 2500-3999g, 2,184 apo 8.8% janë për grup peshën 4000g+ dhe më së paku ka te grup pesha <1000g me 91 apo 0.4% Pesha mesatare në lindje është 3275.4g (Tab. 4a).

Tab.4 Të porsalindurit sipas peshës trupore

Lindje	P e s h a n ë l i n d j e										Total
	Më pak se 1000	1000-1499	1500-1999	2000-2499	2500-2999	3000-3499	3500-3999	4000-4499	4500 e më shumë	E panjohur	
N	53	68	230	789	2999	8763	7319	2225	360	610	23416
%	0.2	0.3	1.0	3.4	12.8	37.4	31.3	9.5	1.5	2.6	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2016


Tab.4a Të porsalindurit sipas peshës trupore

Lindje	P e s h a t r u p o r e					Gjithsej	Pesha mesatare
	Nën 1000	1000-1499	1500-2499	2500-3999	4000+		
N	91	108	828	21486	2184	24697	3275.387
%	0.4	0.4	3.4	87.0	8.8	100.0	-

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

Afro një e katërta (24.3%) apo 5,855 nga 24,092 lindje janë realizuar me prerje cezariene, ndërsa në institucionet private nga gjithsej 489 lindje, 284 apo 58.1% janë me prerje cezariene (Tab.5, Graf.5).

Graf.5 Përqindja e lindjeve sipas mënyrës së lindjes



Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

Në klinikën Gjinekologjike Obstetrike të QKUK-së, afro një e treta e lindjeve janë me prerje Cezariene 3,398 (33.5%). Sipas spitaleve përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariene është realizuar në spitalin e Pejës 689 (32.1%), pason spitali i Gjakovës me 632 (29.9%) dhe spitali i Vushtrisë me 58 (28.3%) (Tab.5).

Tab.5 Lindjet me prerje Cezariane sipas institucioneve shëndetësore, Kosovë 2016

Institucioni		Komuna	Lindje me prerje cezariane		Gjithsej Lindje
			N	%	
Institucionet Publike	QKUK	Prishtina	3398	33.5	10139
	Spitali	Ferizaji	188	11.4	1654
		Gjilani	381	20.6	1852
		Gjakove	632	29.9	2116
		Prizren	191	15.7	1217
		Pejë	689	32.1	2147
		Mitrovica	34	0.9	3619
		Vushtrria	58	28.3	205
Gjithsej- Institucione Publike spitalore			5571	24.3	22949
Gjithsej maternitete			0	0.0	654
Gjithsej në Institucione Publike			5571	24.3	23603
Institucionet Private	Bahceci Health care	Prishtinë	205	84.7	242
	Spitali Amerikan	Prishtinë	79	32.0	247
	Spitali	Prishtinë	0	0.0	0
Gjithsej në Institucione Private			284	58.1	489
Gjithsej			5855	24.3	24092

Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

VDEKSHMËRIA E FOSHNJEVE

Nga numri i përgjithshëm prej 24,852 të të porsalindurve në vitin 2016, institucionet shëndetësore publike dhe private kanë raportuar gjithsej 199 foshnje të vdekura.


Prej gjithsej 199 foshnjeve të vdekura, 121 (60.8%) janë vdekje neonatale të hershme, (foshnje të vdekura 0-6 ditë), vdekjet neonatale (0 deri 28 ditë) përbëjnë 150 (75.4%), vdekje neonatale të vonshme janë 29 (14.6%) dhe 49 (24.6%) janë vdekje postneonatale (Tab.6, Graf 9).

Tab. 6 Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës

Foshnje të vdekura	0- 24 orë	1-6 ditë	7-27 ditë	28-364 ditë	Total
N	33	88	29	49	199
%	16.6	44.2	14.6	24.6	100.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016

Graf. 6 Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës



Nga gjithsej 199 foshnje të vdekura, 116 (58.3%) janë meshkuj dhe 83 (41.7%) femra (Tab.7, Graf.7).

Prej 199 foshnjeve të vdekura, sipas moshës dhe gjinisë nuk ka dallim sinjifikant. Poashtu edhe sipas moshës së nënës dhe statusit martesor nuk ka dallim sinjifikant (Tab.7,8).

Vdekshmëria e foshnjeve sipas rradhës së lindjes së fëmijës në mënyrë sinjifikante ka ndodhë te fëmiu i parë në familje.

Sa i përket nivelit të edukimit 103 ose 51.8% nga 199 foshnje të vdekura janë të nënave me shkollë të mesme dhe 54 ose 27.1% të nënave me shkollë të kryer. (Tab.8).

Tab.7 Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës, gjinisë, moshës së nënës dhe rradhës së lindjes së fëmiut

Modalitete		Gjithsej	Moshë e foshnjeve të vdekura		
			Neonatale e hershme	Neonatale	Post neonatale
		199	121	29	49
Gjinia	%	100	60.8	14.6	24.6
	Meshkuj	116	71	18	27
	Femra	83	50	11	22
			$\chi^2=0.383$, ShL=2, p=0.825		
Moshë e nënës	15-24	35	19	8	8
	25-34	117	74	16	27
	35-44	47	28	5	14
			$\chi^2=3.25$, ShL=4, p=0.516		
Radha e lindjes së fëmiut	I pari	80	53	12	15
	I dyti	50	32	6	12
	I treti	42	19	8	15
	I katërti	16	12	0	4
	> I pesti	11	5	3	3
			$\chi^2=78.4$, ShL=4, p<0.001		


Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016

Tab. 8 Vdekshmëria e foshnjeve sipas statusit martesor të nënës, nivelit të edukimit të edukimit të nënës

Statusi martesor dhe niveli i edukimit të nënës		Moshë e të foshnjeve të vdekura							
		Gjithsej		Neonatale të hershme		Neonatale		Postneonatale	
		N	%	N	%	N	%	N	%
Statusi martesor i nënës	Gjithsej	199	100.0	121	100.0	29	100.0	49	100.0
	E pamartuar	9	4.5	3	2.5	3	10.3	3	6.1
	E martuar	190	95.5	118	97.5	26	89.7	46	93.9
	$\chi^2=3.736$, ShL=2, p=0.154								
Niveli i edukimit të nënës	Pa shkollë	7	3.5	5	4.1	1	3.4	1	2.0
	Shkolla fillore e pa kryer	8	4.0	6	5.0	1	3.4	1	2.0
	Shkolla fillore e kryer	54	27.1	33	27.3	11	37.9	10	20.4
	Shkolla e mesme	103	51.8	56	46.3	12	41.4	35	71.4
	Shkolla e lartë	2	1.0	2	1.7	0	0.0	0	0.0
	Fakulteti	22	11.1	17	14.0	4	13.8	1	2.0
	E panjohur	3	1.5	2	1.7	0	0.0	1	2.0

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016

Graf. 7 Vdekshmëria e foshnjeve sipas grup-moshës dhe gjinisë



Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016

VDEKSHMËRIA FETALE


Sipas IKSHPK, departamentit të Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISH), numri i foshnjeve të lindura vdekur për vitin 2016 ka qenë 156 ose vdekshmëri fetale 6.3%. Sipas niveleve të Kujdesit Shëndetësor 102 ose 65.4% kanë ndodhë në QKUK ndërsa në spitalet private janë raportuar 3 raste ose 1.9% (Tab.9).

Tab.9 Foshnjet e lindura pa jetë sipas institucioneve shëndetësore, 2016

Institucioni	Të lindur pa jetë	
	N	%
QKUK	102	65.4
SPITALI	51	32.7
QKMF	0	0.0
SPITALI PRIVAT	3	1.9
TOTALI	156	100.0

Sipas IKSHPK-së, në nivelin terciar në QKUK, në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike, vdekshmëria fetale është më e larta 9.8%. Sa i përket institucioneve shëndetësore publike (spitaleve të përgjithshme), spitali i Gjilanit vazhdon të ketë shkallën më të lartë të vdekshmërisë fetale (5.9%), pasuar nga spitali i Gjakovës me 5.6% dhe spitali i Pejës me 5.5%. Spitali i Ferizajit nuk ka raportuar asnjë rast të vdekjeve fetale. Ngjashëm me spitalin e Ferizajit, maternitetet e KPSH-së kanë raportuar zero vdekje fetale. Këtë vit janë regjistruar vdekje fetale në institucionet private në shkallën prej 6.0% (tre raste të vdekjeve fetale). Në spitalin privat 'Spitali Amerikan' 8.0% dhe në spitalin Bahceci 4.0% (Graf.8).


Graf. 8 Vdekshmëria fetale sipas institucioneve shëndetësore publike dhe private



Burimi: IKSHPK -Lindjet në Institucionet shëndetësore publike të Kosovës për vitin 2016

Vdekshmëria fetale ka trend të rënies së vazhdueshme. Në vitin 2000 shkalla e vdekshmërisë fetale ishte 14.5% ndërsa në vitin 2016 është 6.3%. (Graf.9).

Graf. 9 Shkalla e vdekshmërisë fetale, 2000-2016



Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016


VDEKSHMËRIA PERINATALE

Vdekshmëria perinatale pasqyron vdekshmërinë fetale dhe vdekshmërinë e hershme neonatale së bashku për një periudhë të caktuar kohore në një territor të caktuar, për krahasim ndërkombëtar.

Në vitin 2016 në Kosovë, shkalla e vdekshmërisë perinatale ishte 8.5%. Sipas komunave shkalla më e lartë është në komunën Mamushë 26.0%, Obiliq 20.3%, Klinë 15.9%, Shtime 15.4%, Prishtinë 13.1% (Tab. 10).

Sipas viteve, shkalla e vdekshmërisë perinatale ka trend të rënies (Graf.10).

Graf.10 Shkalla e vdekshmërisë perinatale, 2011-2016



Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016

Vdekshmëria e hershme neonatale (0 – 6 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së hershme neonatale (0 – 6 ditë) për vitin 2016 është 5.2%. Sipas komunave gjegjësisht vendbanimit të foshnjeve, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së hershme neonatale është në komunën Mamushë 26.0%, Prishtinë 10.1%, Klinë 10.0% dhe Obiliq 8.8% (Tab.11).

Vdekshmëria neonatale e vonshme (7 – 27 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë së vonshme neonatale (7 – 27 ditë) për vitin 2016 është 1.2%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë së vonshme neonatale është në komunën Dragash 9.1%, Han të Elezit 8.2%, Klinë 8.0% dhe Lipjan 3.4% (Tab.11).

Vdekshmëria neonatale (0-28 ditë)

Shkalla e vdekshmërisë neonatale (0-28 ditë) për vitin 2016 është 6.4%. Sipas komunave, shkalla më e lartë e vdekshmërisë neonatale është në komunën Mamushë 26.0%, Klinë 18.0%, Dragash 12.2% dhe Prishtinë 11.3% (Tab.11).

Vdekshmëria postneonatale (28-364 ditë)

Vdekshmëria postneonatale për vitin 2016 është 2.1%. Shkalla më e lartë e vdekshmërisë postneonatale ishte në komunën Junik 27.8%, Shtërpçë 12.3%, Kaçanik 6.3% (Tab.11).

Mortaliteti infantil në Kosovë për vitin 2016 është 8.5%, ndërsa Sipas Raportit European për Shëndetin, 2015, mortaliteti infantil ka dallim të madh në regjonin e Europës, shkalla më e lartë është 22% ndërsa më e ulta 2%.

Mortaliteti infantil sipas komunave, më i larti është në komunën e Junikut me 27.8% dhe Mamushës me 26.0%. Mortaliteti perinatal është 8.5%, ndërsa sipas komunave më i larti është në komunën e Mamushës me 26.0% dhe Obiliqit me 20.3%.

Tab. 10 Shkalla e vdekshmërisë perinatale dhe infantile sipas komunave, 2016

Komuna	Mortaliteti Perinatal 2016	Mortaliteti Infantil 2016
Deçan	0.0	0.0
Gjakovë	9.0	12.6
Glllogovc	14.8	11.5
Gjilan	7.2	12.6
Dragash	6.1	12.2
Istog	4.6	6.8
Kaçanik	6.3	10.6
Klina	15.9	22.0
Fushë Kosovë	6.1	6.1
Kamenicë	4.0	0.0
Mitrovicë	10.9	7.3
Leposaviq	0.0	0.0
Lipjan	7.9	12.4
Novobërdë	0.0	0.0
Obiliq	20.3	8.8
Rahovec	7.1	11.3
Pejë	3.4	6.8
Podujevë	10.6	3.6
Prishtinë	13.1	12.6
Prizren	5.3	6.2
Skenderaj	4.3	5.7
Shtime	15.4	7.8
Shtërpcë	0.0	12.3
Suharekë	2.7	4.1
Ferizaj	10.3	7.8
Viti	3.7	3.7
Vushtrri	11.0	3.0
Zubin Potok	0.0	0.0
Zveqan	0.0	0.0
Malishevë	3.6	3.6
Junik	0.0	27.8
Mamushë	26.0	26.0
Hani i Elezit	0.0	8.2
Graçanicë	0.0	0.0
Ranillug	0.0	0.0
Partesh	0.0	0.0
Klllokot	0.0	0.0
Total	8.5	8.5

Burimi: ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016

PËRFUNDIMI

- Prej gjithsej 24,092 lindje, 24,852 janë të porsalindur, 24,697 të porsalindur gjallë Raporti gjinor në lindje është 1,096.2 meshkuj në 1000 femra
- Shkalla e lindjeve me prerje Cezariane është 24.3 %
- Prej gjithsej 199 foshnjeve të vdekura prej tyre 156 (6.3%) vdekje fetale, 121 (4.9%) vdekje të hershme neonatale (0-6 ditë), 29 (1.2 %) vdekje të vonshme neonatale (7-27ditë), 150 (6.1%) vdekje neonatale (0-28 ditë), 121 (8.5%) vdekje perinatale (vdekje fetale + hershme neonatale), 49 (2.1%) vdekje postneonatale.
- Sipas nivelit të kujdesit shëndetësor, përqindja më e lartë e lindjeve është realizuar në spitale rajonale me 12,810 apo 53.2%, pason QKUK me 10,139 apo 42.1%, në maternitete 654 lindje apo 2.7%, ndërsa në spitalet private, spitali Bahceci dhe spitali Amerikan 489 raste apo 2.0%.
- Numri mesatar i lindjeve në ditë më i larti është në QKUK me 28 lindje, pason spitali i Prizrenit me 10 lindje.
- Lindshmëria për periudhën 2000-2016 ka trend të rënies me lëvizje variabile.
- Me grup-peshë < 2500g janë 5% të foshnjeve të porsalindura.
- Mosha mesatare e nënave në lindje është 28.4 vjet, me përgatitje shkollore të mesme me 9,218 apo 39.4%.
- Sipas gjinisë së të porsalindurve nuk ka dallim sinjifikant edhe pse meshkujt janë 12,826 apo 52.4%.
- Në institucionet publike spitalore 24.3% janë lindje me prerje cezariane kurse në institucionet private 58.1%.
- Në QKUK, afro një e treta e lindjeve janë me prerje Cezariane 3,398 (33.5%). Prej spitaleve rajonale përqindja më e lartë e lindjeve me prerje cezariane është realizuar në spitalin e Pejës 689 (32.1%) dhe spitalin e Gjakovës me 632 (29.9%).
- Vdekshmëria e foshnjeve sipas moshës dhe gjinisë, moshës dhe moshës së nënës, moshës dhe statusit martesor nuk ka dallim sinjifikant ndërsa sipas rradhës së lindjes së fëmijës në mënyrë sinjifikante ka ndodhë te fëmiu i parë në familje.
- Pjesa më e madhe e foshnjeve të vdekura 103 (51.8%) janë të nënave me shkollë të mesme.
- Vdekshmëria fetale ka trend të rënies së vazhdueshme, në Kosovë për vitin 2016 është 6.3%, sipas institucioneve në QKUK është më e larta 9.8%, pason spitali i Gjilanit me 5.9%, spitali privat 'Spitali Amerikan' me 8.0% dhe spitalin Bahceci me 4.0%.

REKOMANDIMET

- Në raportim të të dhënave perinatale të përfshihen të gjitha institucionet, publike dhe private dhe të gjitha komunat.
- Të harmonizohen të dhënat dhe formulari i grumbullimit të të dhënave në mes të ASK-së dhe IKSHPK-së pasi që numri i raportuar i lindjeve dallon sipas burimit. Në raportin e IKSHPK-së mungojnë të dhënat të vdekjet e foshnjëve sipas institucionit, peshës dhe moshës, dallon agregimi i grup peshës në lindje.
- Të përmirësohet niveli i raportimit të të dhënave për vdekjet maternale dhe shkaqet e vdekjeve të foshnjëve.
- Të hartohen udhërrëfyesit dhe protokolet klinike dhe të monitorohet zbatimi i tyre në praktikë.
- Të rritet performanca e institucioneve shëndetësore që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe fëmijë.
- Të fuqizohen shërbimet shëndetësore për nëna dhe fëmijë në KPSh, përmes implementimit të plotë të konceptit të mjekësisë familjare, përfshirë vizitat shtëpiake.
- Të fuqizohet më tutje edukimi i vazhdueshëm profesional i punëtorëve shëndetësor dhe monitorimi i zbatimit në praktikë i njohurive dhe shkathtësive të fituara të jetë prioritet.
- Të përmirësohet infrastruktura, pajisjet dhe furnizimi me barna në institucione që ofrojnë kujdes shëndetësor për nëna dhe foshnje.
- Të fuqizohet qasja multidisciplinare në kujdesin antenatal, natal dhe postnatal.

BIBLIOGRAFIA

1. IKSHPK, Lindjet 2016
2. ASK, Statistikat e Lindjeve në Kosovë, 2016
3. ASK, Statistikat e Vdekjeve, 2016
4. WHO. The European Health Report 2015.
5. Raporti i gjendjes perinatale në Kosovë për vitin 2015, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës, Tetor 2013, Prishtinë.